

20140431272

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REZERVA DETYRUESHME
TË NAFTËS DHE DERIVATEVE TË NAFTËS

Neni 1

Në Ligjin për rezerva detyrueshme të naftës dhe derivate të naftës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 84/2008, 35/11 dhe 84/12) neni 12 ndryshohet si vijon:

“(1) Me punën e Drejtorisë udhëheq drejtor të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion i kundërvajtjes ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
- të ketë fituar 240 kredi sipas SETK ose VII/1 shkallë të arsimit,
- të ketë së paku pesë vjet përvojë pune, nga sfera e derivateve të naftës prej të cilave dy vjet në funksion udhëheqës.
- të ketë dëshmi përkatëse (certifikatë), jo më të vjetër se pesë vjet, për gjuhë të dhënë angleze edhe atë: TOFEL IBT (me së paku 74 pikë), ose IELTS (së paku 6 pikë), ose TOLES (njohje bazike), ose ILEK (së paku B2 nivel) ose Kembrixh certifikatë (niveli B1), ose APTIS (së paku niveli B2) dhe
- të posedojë vërtetim për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.

(3) Drejtori emërohet pas shpalljes publike të realizuar për zgjedhje e cila publikohet në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.”

Neni 2

Dispozitat të nenit 1 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj të cilat do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".